



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

**Legjislatura e V-të**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 9/15

Prishtinë, më 4.3.2015, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Donika Kadaj-Bujupi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, dhe Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Ymer Havolli – Kryetar i Bordit të FKPK-së, Ruzhdi Morina – Antar i Bordit të FKPK-së dhe Adrian Zalli – Drejtor Ekzekutiv i FKPK-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Shefki Kastrati nga NDI, Lumnije Murati nga ZPRK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 18.2.2015;**
- 3. Rishqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura me Raportin me rekomandime të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** - konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 4.3.2015**

**Kryetari** - konstatoj se komisioni miratoi procesverbalin pa vërejtje.

### **3. Rishqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015**

**Kryetari** – siç e keni parë, Fondi ka dorëzuar kërkesën e dytë, me ndryshime dhe nga përmbajtja kemi parë se ka ndryshime në taksën operacionale nga 0.095% sa ka qenë në kërkesën e parë, tanë është zbritur në 0.087%, ku si rezultat janë bërë disa ndryshime në shpenzimet operacionale, ndërsa taksa investive ka mbetur e njëjtë prej 0.40%.

**Adrian Zalli** - theksoi se kemi bërë edhe disa shkurtime drastike sipas propozimit nga mbledhja e fundit e komisionit në buxhetin operacional. Sa i përket taksës investive ajo ka mbetur e njëjtë sepse ajo shkon proporcionalisht me investimet, varësisht nga lëvizjet e çmimeve të tregjeve dhe ajo shumë pak mundet me u prek. Tek shpenzimet e bordit drejtues, i kemi ulë shpenet për hotelet, reprezentacionet dhe mëditjet tjera, po ashtu te shpenzimet e personelit kemi pasur ulje.

**Kryetari** – për shpenzimet bordit drejtues, ka nja zvogëlim prej 46,300 euro, kontributet i keni zvogëluar prej 300 euro. Transportin e keni zvogëluar për 2,500 euro, reprezentacionin e keni zvogëluar për 1500, mëditjet e tjerat janë zvogëluar për 500 euro.

**Adrian Zalli** – sqaroi se Bordi Udhëheqës ka 3 anëtarë ndërkombëtar dhe për ata nuk paguhen kontributet pensionale, por duhet me i pague tatimet, ndërkaq për anëtar e bordit që janë vendor, i paguam si tatimet po ashtu edhe kontributet. Sa i përket sigurimit fiduciar ne kemi zbritur shumë në zero, mirëpo shumë që ka qenë e planifikuar për shpenzim për vitin 2015, e kemi futur të rastësisë, sepse është obligim kontraktual dhe pagesa është bërë me 1 janar të këtij viti. Ndërkaq edhe me kërkesë të komisionit, tash e tutje nuk do të marrim kontratë fiduciare. Te shpenzimet e personelit, i kemi mbajt pagat dhe kontributet pensionale në të njëjtin nivel, ndërsa shujtat i kemi hequr. Kemi bërë zbritje në shpenzimet profesionale për auditorin e jashtëm, ku çmimi do të varet edhe prej procesit tenderues, konsulentët kontraktor ka të bëjë më shumë për udhëtime nga 24,000 euro, dhe është zvogëluar për 4.5%. Zhvlerësimi dhe amortizimi janë paisje kompjuterike dhe çdo aset që kemi duhet me u zhvlerësu sipas rregullave të kontabilitetit dhe nuk mund të bëjmë ndryshime.

**Besa Gaxherri** – pyeti, çdo vit e bëni zhvlerësimin e aseteve?

**Ardian Zalli** – sqaroi se çdo vit bëhet zhvlerësimi proporcionalisht.

**Kryetari** – kërkoi sqarim për pozicionin rregullimet dhe mirëmbajtja e zyrës dhe paisjeve, që është rritur shuma për 1,500 euro, nga kërkesa e parë?

**Ardian Zalli** – sqaroi se rregullimet dhe mirëmbajtja e zyrës dhe paisjeve ka të bëjë me sistemin softuerik që ka një kosto të mirëmbajtjes prej 60,000 euro dhe nuk mundet as me u ulë e as me u ngrit sepse kjo është çmimi që është nxjerr. Mirëmbajtja harduerike është ulur për 66.3%. Rimëkëmbja pas fatkeqësive ka të bëjë me lokacion apo alternativ në rast te një fatkeqësie që mundet me ndodh në zyret qendrore, në duhet me u zhvendos në një vend tjetër dhe duhet ofruar shërbime për kontribuuesit, deri në sanimin e gjendjes së mundshme të krijuar. Mirëmbajtja softuerike ka po ashtu edhe licencën që duhet me ripërtëri. Rregullimet dhe mirëmbajtjet e zyrës ka të bëjë prishjet që mund të ndodhin zyre dhe duhet rregulluar. Mirëmbajtja dhe sigurimi i veturës, ne i kemi dy vetura në shërbim dhe një tjetër nuk është në

përdorim dhe ky shpenzime ka të bëjë me koston e sigurimit të tyre apo ndonjë prishje që ndodh eventualisht. Sigurimi i pajisjeve është për paisjet që i kemi brenda në objekt.

**Besa Gaxherri** – pse keni nevojë për pozicionin “rimëkëmbjen pas fatkeqësive”, ku në rast të ndjonë fatkeqësie, shpenzimet i mbulon sigurimi që bëni?

**Adrian Zalli** – sqaroi se ka nevojë për sigurimin nga fatkeqësitë, se në rast se digjen kompjuterët dhe nuk mundesh me i hap, sigurimi ta mbulon djegën e kompjuterit, por ne kemi një zyrë në të cilën menjëherë shkojmë dhe e aktivizojmë që mos me e lenë krejt sistemin peng të menaxhimit.

**Ruzhdi Morina** - sqaroi se sigurimi prej fatkeqësive është edhe sipas kërkesës së Banka Qendrore dhe të auditorit dhe kjo ka të bëjë më ruajtjen e të dhënave mbi 500,000 njerëz. Të dhënat ne ruajmë në një vend tjetër sepse nëse ndodh diçka duhet ti kemi të dhënat edhe diku tjetër.

**Besa Gaxherri** – pyeti çfarë janë shpenzimet e objektit?

**Kryetari** – njoftoi se në mandatin e kaluar ne e kemi aprovuar çështjen e bunkerit për sigurimin e të dhënave financiare që ka të bëjë me sistemin financiar në Kosovë. Shumë shtete e kanë një sistem të tillë të ruajtjes së të dhënave, në një objekt jashtë zyrës qendrore.

**Adrian Zalli** - shpenzimet e operimit të zyrës ose tarifës e tjera, është tarifa për mbikëqyrje që caktohet nga Banka Qendrore në bazë të rregullores së tyre dhe është ulur në 9,500 euro.

**Kryetari** - theksoi se ka institucione të mëdha gjyqësore që kanë dalin në objekte të reja shtetërore, duhet edhe ju me u interesua dhe bë kërkesë Ministrisë së Administratës Publike për me iu sigurue hapësirë në objekte shtetërore, në mënyrë që të liroheni edhe nga pagesa e qerasë së objektit.

**Latif Gashi** – në lidhje me shpenzimet e operimit të zyrës, tarifave për mbikëqyrjen që keni ndaj BQK në, në vitin 2014 e keni pasur 20,000 euro, këtë vit e keni kërkuar 10,000 euro, ku qëndron arsyeja e këtij ndryshimi?

**Adrian Zalli** – sqaroi se dallim ka qenë se në vitin 2014, ka qenë për totalin e dy taksave, investuese edhe operative dhe pas ndarjes së taksave, BQK-ja e ka marr vendimin se kjo aplikohet vetëm në taksën administrative apo operacionale dhe kjo është rezultat i zbritjes së çmimit të tarifës. Sa i përket sigurimit fizik, ka të bëjë me sigurimin e objektit dhe është kontrata në bazë të së cilës bëhet pagesa.

**Latif Gashi** – krahasimet me vitin 2014, shihet se shpenzimet apo çmimet për vitin 2015 i keni propozuar më të ulëta, a do të thot se keni pasur ndonjë luks të madh në vitin 2014?

**Adrian Zalli** - nuk kemi pasur ndonjë luks të madh, por kanë mbetur mjetet shtesë të cilat i kemi marrë dhe kërkojmë me e zbrit taksën operacionale edhe më shumë, përndryshe po te kishim dashur me e mbajtur ashtu luks, e kishim propozuar taksën e njëjtë si vitin e kaluar prej 0.13% .

**Besa Gaxherri** – kërkojë sqarime për kategorinë “ rastësitë” dhe shpenzimet “të ndryshme”?

**Adrian Zalli** - shpenzimet e ndryshme janë ato shpenzime që kemi pas raste kur një operator nuk e ka dërguar një faturë për një vit dhe e ka dërguar si një shpenzim tjetër. Sa i përket rastësive ka të bëjë edhe

me atë që sqarove për sigurimin fiduciar për këtë vit që është kontraktuar dhe janë më të mëdha dhe si total shumat e këtyre dy shpenzimeve, janë prej 52,000 euro.

**Besa Gaxherri** – i sugjeroi përfaqësuesit e Fondit, që në propozimin e taksave për vitin tjetër, të jenë më të përgjegjshëm në planifikimin e nevojave të arsyeshme të shpenzimeve apo buxhetit të Fondit, sepse ky buxheti siç është propozuar tani, nuk do të kalojë.

**Kryetari** – sa i përket suficitit të akumuluar nga aktivitetet investuese, Fondi nuk mundet me i shfrytëzue asnjë cent, jashtë taksës vjetore menaxhuese që e cakton Kuvendi dhe shpenzimet duhet të jenë në kuadër të taksës vjetore. Pra, nuk mundet me u ba bartja e mjeteve nga një vit në një vit tjetër. Prandaj shuma prej 870,000 si suficit i akumuluar, Fondi duhet me iu kthye kontributdhënësve, me një vendim që duhet me e nxjerr Fondi. Prandaj, propozimi im është që si komision të rekomandojmë Kuvendit, miratimin e taksës operationale prej 0,087% dhe taksës investive prej 0,40%. Po ashtu një rekomandim i Komisionit të jetë që Fondi, suficitin e akumuluar nga aktivitetet investues, ta kthejë në llogaritë individuale të kontributeve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këto

### **Rekomandime**

1. Të miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksën operationale prej 0,087% dhe taksën investive prej 0,40%, për vitin 2015.
2. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, suficitin e akumuluar nga aktivitetet investuese, në vlerë prej 870,000 (tetëqind e shtatëdhjetë mijë) Euro, të kthejë në llogaritë individuale të kontribuuesve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura me Raportin me rekomandime të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së**

**Kryetari** - theksoi se projektligji nuk përmban kosto buxhetore shtesë, ndërsa komisioni funksional nuk ka propozuar amendamente.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

Projektligji nr.05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

## **5. Të ndryshme**

**5.1. Kryetari** - njoftoi se ka biseduar me GIZ-in për organizimin e një workshopi, që është planifikuar të mbahet më 10 mars, në Vila Gërmia, dhe në këtë takim do të merr pjesë dhe prezantojë eksperti i njohur i financave publike, nga Shqipëria, Petraq Milo dhe tema do të jetë lidhur me parashikimet e indikatorëve kryesore makroekonomikë dhe buxheti 2015. Të gjithë anëtarët e komisionit janë të ftuar dhe për agjendën do të njoftohen edhe njëherë nga stafi mbishtesës i komisionit. Po ashtu kryetari

njoftoje anëtarët se Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar prej 19-30 mars do të jetë në Kosovë dhe me 27 mars 2015, në ndërtesën e Qeverisë, prej orës 9:00 deri në 11:30, është planifikuar një takim i përbashkët, në mes përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe përfaqësuesve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në të cilin takim, Misioni i FMN-se, do të prezantoj tri studime në fusha të ndryshme të ekonomisë. Për më tepër për këtë takim, do të njoftoheni nga stafi mbështetës i komisionit.

**Mbledhja përfundoi në ora 13:45**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Naser Osmani**